

Data: 13.08.2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “OPERIM DHE MIRËMBAJTJE E ASETIT GJENERUES TERMİK, VLORË”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbime mirëmbajtjeje- 98341110-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,855,475,370 (Njëmiliard e tetëqind e pesëdhjetë e pesëmilion e katërqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e treqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 23,026,500 (Njëzet e tremilion e njëzet e gjashtëmijë e pesëqind) USD pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 13/08/2026 është 80.58 Lekë/USD.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH sh.a.) ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në nenin 90 “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriteret për kualifikim 2.2.1, 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8, argumentuar si më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor nuk lejon mbështetjen në kapacitetet ekonomike dhe financiare të subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterit 2.2.1, pasi kërkesa për xhiron vjetore synon të garantojë që vetë operatori ekonomik, i cili do të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për ekzekutimin e kontratës, disponon kapacitetin financiar të nevojshëm për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.1, pasi përvoja e mëparshme në shërbime të ngjashme përbën një element thelbësor të aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik që do të marrë përsipër realizimin e kontratës. Kërkesa për realizimin e shërbimeve të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit synon të garantojë se operatori ekonomik ofertues ka përvojë konkrete, të drejtpërdrejtë dhe të provuar në realizimin e shërbimeve të ngjashme në natyrë, kompleksitet dhe volum me shërbimin objekt të prokurimit. Përvoja e kërkuar lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit

ekonomik për të organizuar, menaxhuar dhe realizuar me sukses detyrimet që do të marrë përsipër në kuadër të kontratës.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.2, pasi certifikatat ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 lidhen drejtpërdrejt me sistemet e menaxhimit të vetë operatorit ekonomik që do të realizojë kontratën. Këto certifikime dëshmojnë se operatori ekonomik disponon dhe zbaton sisteme të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë, të përshtatura me natyrën e shërbimit objekt të prokurimit.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve për kriterin 2.3.3, pasi kërkesa për të pasur minimalisht 50 punonjës në stafin e operatorit ekonomik lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin e tij real organizativ dhe njerëzor për realizimin e shërbimit objekt të prokurimit. Ky kapacitet është i nevojshëm për të garantuar mbulimin e vazhdueshëm të shërbimit, organizimin e personelit, kryerjen e mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve të nevojshme, si dhe reagimin në kohë ndaj situatave që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kontratës. Për këtë arsye, punonjësit duhet të jenë pjesë e stafit të vetë operatorit ekonomik dhe të jenë realisht në dispozicion të tij.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.5, pasi drejtuesi teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, përbën një kapacitet profesional të drejtpërdrejtë dhe të nevojshëm për drejtimin dhe mbikëqyrjen teknike të shërbimit objekt të prokurimit. Duke qenë se drejtuesi teknik do të ketë rol të drejtpërdrejtë në organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të shërbimit, Autoriteti Kontraktor kërkon që ky person të jetë pjesë e stafit të vetë operatorit ekonomik dhe të jetë realisht në dispozicion gjatë periudhës së përcaktuar të kontratës.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.6, pasi punonjësi i pajisur me certifikatën përkatëse përbën një kapacitet profesional të nevojshëm për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë gjatë realizimit të shërbimit. Duke qenë se ky person duhet të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik dhe të jetë realisht në dispozicion gjatë periudhës së përcaktuar, ai do të ketë rol të drejtpërdrejtë në zbatimin dhe monitorimin e masave të sigurisë gjatë ekzekutimit të kontratës.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.7, pasi deklarata mbi organizimin teknik të shërbimit lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si vetë operatori ekonomik do të organizojë dhe realizojë kontratën. Deklarata përcakton funksionet dhe përgjegjësitë, organizimin e personelit, mbulimin e operimit dhe mirëmbajtjes, ndërhyrjet parandaluese dhe korrigjuese, si dhe mënyrën e reagimit ndaj defekteve dhe situatave emergjente. Këto elemente përbëjnë organizimin real të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimit dhe konsiderohen aspekte të rëndësishme të ekzekutimit të kontratës.

Nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriterin 2.3.8, pasi deklarata për furnizimin dhe zëvendësimin e pjesëve rezervë përbën një angazhim të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Angazhimi për furnizimin e pjesëve rezervë, respektimin e specifikimeve teknike dhe zëvendësimin e tyre në kohën e nevojshme është i lidhur drejtpërdrejt me vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me nenin 82, "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", dhe nenin 83, "Sigurimi i Ofertës", të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, dhe neni 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor kërkon paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të procedurave me vlerë të vogël.

Gjithashtu, neni 82 i të njëjtut ligj parashikon se, së bashku me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në vend të disa dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, ndërsa përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas Shtojcës 10).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja "a", dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Kërkesa synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës plotësojnë kushtet ligjore për ushtrimin e aktivitetit profesional dhe kanë të drejtë të ofrojnë shërbimet objekt të procedurës së prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.1 është hartuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, të cilat i japin të drejtë Autoritetit Kontraktor të kërkojë prova mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e aftësisë së tyre për realizimin e kontratës.

Duke marrë në konsideratë natyrën, objektin, vlerën dhe rëndësinë e procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë të provojnë disponimin e kapaciteteve të mjaftueshme ekonomike dhe financiare për përmbushjen me sukses të kontratës, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Për këtë arsye është kërkuar paraqitja e vërtetimit të xhiros vjetore për tre vitet e fundit financiare, duke përcaktuar se vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e fondit limit. Ky nivel është në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe është proporcional me objektin dhe vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor ka parashikuar shprehimisht se kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një nga tre vitet financiare të kërkuara, pa qenë e nevojshme që kjo vlerë të realizohet në secilin prej tyre.

Përcaktimi i viteve financiare të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros është bërë në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, konkretisht: Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 09.04.2025, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, 'Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike"; Udhëzimin nr. 24, datë 06.11.2025, "Për disa shtesa dhe një ndryshim në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 26, datë 08.09.2023, 'Për tatimin mbi të ardhurat'", të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, Për prokurimin publik, të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Për këtë arsye është kërkuar që vlera e shërbimeve të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit, në përputhje me kufirin maksimal të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për organizimin, administrimin dhe realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe afatet e zbatimit. Përvoja e mëparshme në realizimin e kontratave të ngjashme përbën një tregues të besueshëm të aftësisë së operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktore, për të garantuar cilësinë e shërbimeve dhe për të minimizuar rrezikun e mosrealizimit ose të realizimit jo cilësor të kontratës, duke mbrojtur interesin e Autoritetit Kontraktor.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, të cilat duhet të përkojnë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ SSH/EN/ISO 9001: – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë;
- ✚ SSH/EN/ISO 14001: – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor;
- ✚ SSH/EN/ISO 45001: – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin teknik të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë sisteme të certifikuara të menaxhimit, të cilat dëshmojnë aftësinë e tyre për të realizuar shërbimin në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë.

Konkretisht:

SSH/EN/ISO 9001 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, dëshmon se operatori ekonomik zbaton një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë, i cili mundëson planifikimin, monitorimin dhe kontrollin e proceseve të punës, duke garantuar realizimin e shërbimit në përputhje me kërkesat teknike dhe kontraktore.

SSH/EN/ISO 14001 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, dëshmon se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit mjedisor për identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit gjenerues termik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

SSH/EN/ISO 45001 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, dëshmon se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke qenë se shërbimet objekt prokurimi zhvillohen në një impiant industrial me rreziqe të shtuara për personelin, pajisjet dhe mjedisin e punës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht 50 (pesëdhjetë) punonjës për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026:

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është hartuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, sipas të cilave Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë prova mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, përfshirë disponimin e personelit të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se operatori ekonomik duhet të disponojë një numër minimal prej 50 (pesëdhjetë) punonjësish, me qëllim garantimin e kapacitetit organizativ dhe njerëzor të nevojshëm për realizimin e shërbimit.

Aseti gjenerues termik është një infrastrukturë teknike komplekse, funksionimi i së cilës kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe të koordinuar të personelit në disa fusha profesionale, përfshirë operimin e impiantit, mirëmbajtjen mekanike dhe elektrike, automatizimin dhe kontrollin, instrumentacionin, sistemet ndihmëse, si dhe monitorimin teknik dhe të sigurisë.

Kryerja e shërbimit nuk kufizohet vetëm në ndërhyrje periodike mirëmbajtjeje, por përfshin operimin e vazhdueshëm të asetit, monitorimin e parametrave të funksionimit, evidentimin dhe trajtimin në kohë të anomalive, mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, si dhe gatishmërinë për ndërhyrje teknike gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Për shkak të karakterit të vazhdueshëm të shërbimit, kërkesa për një numër minimal punonjësish synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitet real për: *sigurimin e mbulimit të vazhdueshëm të operimit të asetit; organizimin e personelit në turne dhe/ose orare të ndryshme pune, sipas nevojave të operimit; disponimin e personelit të mjaftueshëm për mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese; reagimin në kohë ndaj defekteve, avarive apo situatave të paparashikuara teknike; mbulimin paralel të disiplinave të ndryshme teknike që kërkojnë për funksionimin e një asemi gjenerues termik; garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, edhe në rast mungesash të përkohshme të personelit për shkak të lejeve, sëmundjeve, trajnimeve apo faktorëve të tjerë; ruajtjen e një niveli të përshtatshëm të sigurisë teknike dhe operacionale gjatë kryerjes së punimeve të operimit dhe mirëmbajtjes.*

Për sa më sipër, kërkesa për minimumi 50 (pesëdhjetë) punonjës konsiderohet teknikisht e nevojshme dhe e lidhur me objektin e kontratës, pasi siguron që operatori ekonomik të disponojë kapacitetin njerëzor të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së një asemi gjenerues termik, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit, reagimin në kohë ndaj problematikave teknike dhe realizimin e mirëmbajtjes së planifikuar dhe korrigjuese.

Përcaktimi i periudhës Maj 2026 – Korrik 2026 për verifikimin e personelit synon të dëshmojë se operatori ekonomik disponon kapacitet njerëzor të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së Asetit Gjenerues Termik, Vlorë. Për këtë arsye, periudha tre-mujore konsiderohet e nevojshme për të vlerësuar qëndrueshmërinë, kapacitetin organizativ dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për të përballuar kërkesat e shërbimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026 në stafin e tij punonjësit si më poshtë:

- ✚ 2 (dy) Inxhinier mekanik;
- ✚ 2 (dy) Inxhinier elektrik;
- ✚ 1 (një) Inxhinier mjedisi;
- ✚ 1 (një) Teknik Mekanik;
- ✚ 2 (dy) Teknik Elektrik;
- ✚ 1 (një) Teknik Informacioni.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme.
- ✚ Diplomë / Çertifikatat të lëshuara nga institucionet e autorizuara me ligj.
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik dhe rëndësinë e kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel teknik të specializuar në fushat mekanike, elektrike, mjedisore dhe të mirëmbajtjes industriale, me qëllim garantimin e realizimit të sigurt dhe cilësor të shërbimit.

Konkretisht:

2 (dy) Inxhinier mekanik:

Inxhinierët Mekanikë janë të nevojshëm për mbulimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve dhe pajisjeve mekanike dhe termike të asetit. Ata do të angazhohen në kontrollin teknik,

inspektimin, planifikimin dhe ndjekjen e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrektive, diagnostikimin e problematikave dhe defekteve, si dhe në mbikëqyrjen e ndërhyrjeve teknike. Kërkesa për këtë profil lidhet drejtpërdrejt me faktin se funksionimi i një aleti gjenerues termik varet në mënyrë thelbësore nga gjendja teknike dhe mirëfunksionimi i pajisjeve mekanike dhe termike.

2 (dy) Inxhinier elektrik:

Inxhinierët Elektrikë janë të nevojshëm për mbulimin teknik të sistemeve elektrike që lidhen me funksionimin e asetit, duke përfshirë sistemet e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë, motorët, panelet, pajisjet e mbrojtjes, komandimit dhe pajisjet e tjera elektrike. Angazhimi i tyre është i domosdoshëm për kontrollin, monitorimin, diagnostikimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, si dhe për identifikimin dhe trajtimin në kohë të problematikave që mund të ndikojnë në sigurinë dhe vijueshmërinë e operimit.

1 (një) Inxhinier mjedisi:

Inxhinieri i Mjedisit është i nevojshëm për ndjekjen dhe administrimin e aspekteve mjedisore që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen e asetit gjenerues termik. Ky inxhinier mbulon monitorimin e çështjeve mjedisore, ndjekjen e menaxhimit të mbetjeve dhe respektimin e kërkesave dhe detyrimeve mjedisore që lidhen me aktivitetin, duke kontribuar në realizimin e shërbimit në përputhje me kërkesat mjedisore të zbatueshme për këtë objekt prokurimi.

1 (një) Teknik Mekanik:

Tekniku Mekanik është i nevojshëm për mbështetjen teknike në terren të aktiviteteve të mirëmbajtjes së pajisjeve mekanike. Ai asiston në kontrollet dhe inspektimet teknike, mirëmbajtjen rutinë dhe ndërhyrjet praktike në pajisje, në koordinim me personelin inxhinierik, duke mundësuar realizimin në kohë dhe me efektivitet të punimeve të mirëmbajtjes.

2 (dy) Teknik Elektrik:

Teknikët Elektrikë janë të nevojshëm për realizimin e punimeve praktike të kontrollit, mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve në pajisjet dhe instalimet elektrike të asetit. Këta Teknik sigurojnë mbështetjen në terren për mirëmbajtjen parandaluese dhe korrektive, diagnostikimin dhe eliminimin e problematikave elektrike, si dhe reagimin në kohë ndaj defekteve. Prania e tyre është e rëndësishme për garantimin e vazhdimësisë së operimit dhe realizimin e ndërhyrjeve në përputhje me kërkesat e sigurisë teknike.

1 (një) Teknik Informacioni:

Tekniku i Informacionit është i nevojshëm për mbështetjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike dhe të komunikimit që përdoren në funksion të operimit, monitorimit dhe

administrimit të asetit. Ky punonjës siguron garantimin e funksionalitetit të infrastrukturës së informacionit dhe në adresimin në kohë të problematikave teknike që mund të ndikojnë në proceset e monitorimit, komunikimit dhe operimit.

Përcaktimi i periudhës Maj 2026 – Korrik 2026 për verifikimin e personelit synon të dëshmojë se operatori ekonomik disponon kapacitet njerëzor të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së Asetit Gjenerues Termik, Vlorë. Për këtë arsye, periudha tre-mujore konsiderohet e nevojshme për të vlerësuar qëndrueshmërinë, kapacitetin organizativ dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për të përballuar kërkesat e shërbimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) drejtues teknik i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

 Kontratë pune të vlefshme.

 Diplomë.

 Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

****Sqarim: Inxhinieri i kërkuar në këtë kriter mund të plotësohet edhe nga inxhinierët mekanik të kërkuar në kriterin 2.3.4.***

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik dhe rëndësinë e kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një drejtues teknik Inxhinier Mekanik, i cili të garantojë drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen teknike të të gjitha aktiviteteve që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit gjenerues termik.

Realizimi i kontratës kërkon njohuri të specializuara në sistemet mekanike industriale, mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike, diagnostikimin dhe analizimin e defekteve, planifikimin e ndërhyrjeve parandaluese dhe korrigjuese, si dhe koordinimin e punimeve në pajisjet kryesore dhe ndihmëse të impiantit. Për këtë arsye, disponimi i një drejtuesi teknik me profil mekanik është i domosdoshëm për organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin teknik të shërbimeve që do të realizohen gjatë zbatimit të kontratës.

Drejtuesi teknik do të jetë përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e stafit teknik, ndjekjen e zbatimit të procedurave të mirëmbajtjes, monitorimin e cilësisë së shërbimeve, respektimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë në punë, si dhe për garantimin e funksionimit të sigurt dhe të vazhdueshëm të impiantit.

Përcaktimi i periudhës Maj 2026 – Korrik 2026 për verifikimin e personelit synon të dëshmojë se operatori ekonomik disponon kapacitet njerëzor të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së Asetit Gjenerues Termik, Vlorë. Për këtë arsye, periudha tre-mujore konsiderohet e nevojshme për të vlerësuar qëndrueshmërinë, kapacitetin organizativ dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për të përballuar kërkesat e shërbimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Çertifikatën përkatëse;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026.

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Gjithashtu, ky kriter është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar si dhe VKM Nr.108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, e cila ka për objekt operimin dhe mirëmbajtjen e një impianti gjenerues termik, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën një specialist të kualifikuar si Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Prania e këtij specialisti është e nevojshme për organizimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve profesionale, hartimin dhe ndjekjen e masave parandaluese, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe procedurave të sigurisë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Duke qenë se aktivitetet objekt prokurimi zhvillohen në një impiant me procese teknologjike dhe rreziqe të shtuara për personelin, pajisjet dhe mjedisin e punës, disponimi i këtij specialisti përbën një kërkesë të domosdoshme për garantimin e një mjedisi pune të sigurt dhe për minimizimin e rrezikut të aksidenteve në punë.

Përcaktimi i periudhës Maj 2026 – Korrik 2026 për verifikimin e personelit synon të dëshmojë se operatori ekonomik disponon kapacitet njerëzor të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së Asetit Gjenerues Termik, Vlorë.

Për këtë arsye, periudha tre-mujore konsiderohet e nevojshme për të vlerësuar qëndrueshmërinë, kapacitetin organizativ dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për të përballuar kërkesat e shërbimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë mbi organizimin teknik të shërbimit, në përputhje me kërkesat e shërbimit objekt të prokurimit.

Deklarata duhet të paraqesë, në mënyrë të qartë:

- funksionet dhe përgjegjësitë kryesore;
- mënyrën e organizimit të personelit;
- mënyrën e mbulimit të operimit dhe mirëmbajtjes;
- organizimin e shërbimit për ndërhyrjet parandaluese dhe korrigjuese;
- mënyrën e reagimit ndaj defekteve dhe situatave emergjente.

Argumentimi: Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një deklarate mbi organizimin teknik të shërbimit, në përputhje me kërkesat e shërbimit objekt të prokurimit, është përcaktuar në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e kontratës, e cila kërkon një organizim të qartë të burimeve

njerëzore dhe një strukturë funksionale për garantimin e operimit të pandërprerë të impiantit dhe realizimin në kohë të ndërhyrjeve të mirëmbajtjes.

Paraqitja e kësaj deklarate i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë kapacitetin organizativ të operatorit ekonomik, mënyrën e shpërndarjes së përgjegjësiive teknike, organizimin e personelit sipas funksioneve përkatëse, si dhe aftësinë për të siguruar koordinimin dhe menaxhimin efektiv të proceseve teknike gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër zëvendësimin dhe furnizimin me pjesë rezervë, në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike dhe Termave të Referencës.

Deklarata duhet të përfshijë angazhimin për:

- furnizimin e pjesëve rezervë të kërkuara;
- respektimin e specifikimeve teknike;
- zëvendësimi e pjesëve në kohën e nevojshme për realizimin e mirëmbajtjes;

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Sigurimi i pjesëve rezervë në përputhje me specifikimet teknike mundëson kryerjen në kohë të ndërhyrjeve parandaluese dhe korrigjuese, shmangien e zgjatjes së kohës së qëndrimit jashtë pune të pajisjeve dhe ruajtjen e parametrave të kërkuar të funksionimit.

Angazhimi për furnizimin dhe zëvendësimin në kohën e nevojshme është veçanërisht i rëndësishëm në rastet e defekteve të komponentëve, pasi vonesat në sigurimin e pjesëve mund të ndikojnë në disponueshmërinë dhe performancën e asetit gjenerues termik. Për sa më sipër, ky kriter është synon të garantojë që operatori ekonomik të sigurojë pjesët rezervë të nevojshme, në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afateve të nevojshme për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes.

Shënim i rëndësishëm: Referuar pikës 9 të Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike, Autoriteti Kontraktor fton të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në një vizitë në **asetin gjenerues termik, Vlorë**, e cila do të zhvillohet më datë **31.08.2026, ora 10:00**.

Parashikimi i vizitës në impiantin gjenerues termik është i nevojshëm duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit. Vizita i mundëson operatorëve ekonomikë të interesuar të njihen drejtpërdrejt me konfigurimin, gjendjen dhe karakteristikat teknike të asetit, pajisjet dhe sistemet përbërëse, kushtet e aksesit dhe të

operimit, si dhe me elementë të tjerë teknike që mund të ndikojnë në organizimin dhe realizimin e shërbimit.

Kjo njohje në terren ndihmon operatorët ekonomikë në vlerësimin më të saktë të kërkesave për operim, mirëmbajtje, ndërhyrje teknike dhe burime të nevojshme për zbatimin e kontratës, duke mundësuar përgatitjen e ofertave mbi një informacion sa më të plotë dhe real lidhur me kushtet e zbatimit të shërbimit.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure).

Specifikimet teknike dhe Termat e Referencës hartohen në kuadër të përfundimit të afatit të kontratës aktuale për shërbimin e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) së Asetit Gjenerues Termik për prodhimin e energjisë elektrike. Duke qenë se ky aset ka një rëndësi kritike për vazhdimësinë e aktivitetit dhe sigurinë energjetike, ndërprerja e operimit të tij mbart risqe të larta operationale dhe financiare. Për këtë arsye, shoqërisë KESH sh.a i lind nevoja për iniciimin e një procedure të re prokurimi me qëllim gjetjen e një ofruesi të ri shërbimi të specializuar.

Për të garantuar një operim të vazhdueshëm të Asetit Gjenerues Termik, si dhe për të siguruar një proces konkurrues, transparent dhe në përputhshmëri të plotë me Nenin 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është i domosdoshëm hartimi i Termave të Referencës (ToR) dhe Specifikimeve Teknike të detajuara. Këto dokumente do të shërbejnë si materiali kryesor dhe mbështetës për hartimin e kontratës me Ofruesin e ri të Shërbimit. Si përfundim, shoqërisë KESH sh.a i lind nevoja të prokurojë shërbimin "Operim dhe Mirëmbajtje e Asetit Gjenerues Termik, Vlorë”.

Njësia e Prokurimit